



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 54

Tiranë – E martë, 31 mars 2020

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 21/2020 datë 5.3.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.....	3297
Dekret i Presidentit nr. 11455, datë 26.3.2020	Për shpallje ligji.....	3302
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 30.3.2020	Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve.....	3302
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 30.3.2020	Për indeksimin e pensioneve.....	3303



**LIGJ**  
**Nr. 21/2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**  
**NË LIGJIN NR. 89/2014 “PËR PAJISJET**  
**MJEKËSORE”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 89/2014, “Për pajisjet mjekësore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh” me këtë përmbajtje:

“d) produkte të dedikuara posaçërisht për pastrimin, dezinfektimin ose sterilizimin e pajisjeve;

dh) pajisjet të cilat nuk janë të destinuara për një qëllim të caktuar mjekësor si më poshtë:

i) produkte të destinuara për t’u futur plotësisht ose pjesërisht në trupin e njeriut përmes mjeteve invazive kirurgjikale, me qëllim të modifikimit të anatomisë ose fiksimit të pjesëve të trupit, me përjashtim të produkteve për tatuazhe dhe *piercing*;

ii) substancat, kombinime të substancave, ose produkte të destinuara për t’u përdorur për mbushjen e mukozës së fytyrës ose zona të tjera të lëkurës ose mukozës me anë të injeksionit

subkutan, submukozë ose intradermal, duke përjashtuar ato për tatuazhe;

iii) pajisjet e destinuara për t’u përdorur për të zvogëluar, hequr ose shkatërruar indin dhjamor, siç janë pajisjet për liposuction, lipolizë ose lipoplastikë;

iv) rrezatimi elektromagnetik me intensitet të lartë, të tilla si: pajisje që lëshojnë rrezatim infra të kuq, dritë të dukshme dhe ultra vjollcë, të destinuar për përdorim në trupin e njeriut, duke përfshirë burime koherente dhe jokohereente, spektër monokromatik dhe të gjerë, si lazer dhe pajisje të lehta me pulsime intens, për rishfaqjen e lëkurës, tatuazhi ose heqja e flokëve ose trajtim tjetër i lëkurës;

v) pajisjet e destinuara për stimulimin e trurit që aplikojnë rryma elektrike ose fusha magnetike ose elektromagnetike që depërtojnë në kranium për të modifikuar aktivitetin neuronal në tru.”.

2. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. “Prodhues i një pajisjeje mjekësore” është çdo person juridik, përgjegjës për projektimin, prodhimin, paketimin, udhëzimet për përdorim dhe etiketimin e pajisjes përpara se ajo të vendoset në treg nën emrin e tij, si dhe tregtimin me shumicë të pajisjes, pavarësisht nëse këto veprime janë kryer nga vetë personi ose në emër të tij nga një palë e tretë. Konsiderohet prodhues, në kuptim të këtij ligji, edhe çdo person juridik, i cili mbledh, paketon, rinovon plotësisht proceset dhe/ose etiketat e pajisjeve mjekësore, duke i vendosur në treg nën emrin e tij.”.

3. Pas pikës 18 shtohen pikat 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28 me këtë përmbajtje:

“19. “Komiteti i etikës” është organ i pavarur, i përbërë nga profesionistë të shëndetit ose jo, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së personave të përfshirë në hetimin klinik.

20. “Hetim klinik” është çdo hetim sistematik, që përfshin një ose më shumë persona, i ndërmarrë për të vlerësuar sigurinë ose funksionimin e një pajisjeje.

21. “Paketë procedurale” është një kombinim i produkteve të paketuara së bashku dhe të vendosura në treg, në mënyrë që të përdoren për qëllime specifike mjekësore.

22. “Sistem” është një kombinim i produkteve të paketuara së bashku apo jo, të cilat kanë për

<sup>1</sup> Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2017/745 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 prill 2017, “Për pajisjet mjekësore, që ndryshon Direktivën 2001/83/KE, Rregulloren (KE) Nr. 178/2002 dhe Rregulloren (KE) Nr. 1223/2009 dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 90/385/KEE dhe 93/42/KEE”. Numri CELEX 32017R0745, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 117, datë 5.5.2017, faqe 1-175.



qëllim të jenë të ndërlidhura ose të kombinuara për të arritur një qëllim të veçantë mjekësor.

23. “Përfaqësues i prodhuesit të pajisjes mjekësore” është çdo person juridik ose fizik, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, i cili, i përcaktuar qartë, me shkrim, nga prodhuesi, vepron në vend të prodhuesit lidhur me detyrimet e këtij të fundit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

24. “Etiketim” është informacioni i shkruar, i shtypur ose grafik, që shfaqet ose në vetë pajisjen ose në paketim të çdo njësie apo në paketimin e pajisjeve të shumëfishta.

25. “Instruksionet për përdorim” është fletëpalosja që përmban informacion për përdoruesin dhe që shoqëron pajisjen e gatshme për përdorim.

26. “Kthim produkti” është çdo masë që synon kthimin të prodhuesit të një pajisjeje, e cila tashmë është vënë në dispozicion të përdoruesit përfundimtar.

27. “Ndalimi i tregut” është çdo masë, e cila ka për qëllim parandalimin e kalimit të një pajisjeje në zinxhirin e furnizimit, që të vihet në dispozicion në treg.

28. “Autoriteti kompetent” është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.”.

Neni 2

Në nenin 5 dhe në të gjithë përmbajtjen e ligjit, fjala “fabrikim” zëvendësohet me fjalën “prodhim”.

Neni 3

Në nenin 9, pika 1, dhe në të gjithë përmbajtjen e ligjit fjalët “klasat II a dhe II b” zëvendësohen me fjalët “klasën “II”.

Neni 4

Në nenin 11, pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Kur komiteti i etikës konstaton se kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, ose aktet nënligjore që lidhen me hetimin klinik nuk plotësohen, atëherë i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë:

a) të revokojë autorizimin për hetimin klinik;

b) të pezullojë ose të përfundojë hetimin klinik;

c) të kërkojë që sponsori të modifikojë çdo aspekt të hetimit klinik.

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komitetit të etikës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

### Procesi i regjistrimit

1. Të gjitha pajisjet mjekësore, që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, për pajisjet e klasave II dhe III, kryhet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i prodhuesit në Republikën e Shqipërisë apo tregtuesi me shumicë, i pajisur me autorizim nga prodhuesi.

3. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, për pajisjet e klasës I, kryhet nga të gjitha subjektet që vendosin në treg pajisje të kësaj klase. Aplikimi bëhet në formë elektronike, pranë strukturës përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Kjo e fundit, brenda 5 ditëve pune, njofton në rrugë elektronike subjektin për regjistrimin e pajisjes mjekësore në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore.

4. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore, për pajisjet e klasave II dhe III, brenda 30 ditëve pune, nga data e marrjes së aplikimit.

5. Certifikata e regjistrimit është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare nga data e lëshimit.

6. Të gjitha subjektet që importojnë pajisjet mjekësore të klasave II dhe III, të regjistruara më parë në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, duhet të dërgojnë në rrugë elektronike një vetëdeklarim, brenda 10 ditëve të



çlirimit për tregtim të lirë të çdo pajisjeje të regjistruar, me këto të dhëna:

- a) sasinë e pajisjeve mjekësore të importuara;
- b) serinë/lot;
- c) skadencat.

7. Të gjitha subjektet që vendosin në treg pajisje të klasave II dhe III caktojnë një person përgjegjës për pajisjet mjekësore. Personi përgjegjës duhet të jetë me diplomë jurist, inxhinier biomjekësor/klinik, elektronik/kimik, fizik, mekanik, elektrik mjek i përgjithshëm/stomatolog, farmacist, ose në shkencë mjekësore të ngjashme.

8. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me autorizim të posaçëm, mund të lejojë vendosjen në shërbim të pajisjeve mjekësore për raste të veçanta, të përcaktuara me urdhër të tij.”.

#### Neni 6

Në nenin 16, pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, në rast se është konstatuar se pajisja paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e pacientëve, përdoruesve ose personave të tjerë.”.

#### Neni 7

Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të certifikimit FDA.”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “markimin CE” shtohen fjalët “ose certifikimit FDA”.

#### Neni 8

Në nenin 19, fjala “personat” zëvendësohet me fjalët “tregtuesit e pajisjeve mjekësore”.

#### Neni 9

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

#### Etiketimi dhe instruksionet për përdorim

1. Çdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshme.

2. Instruksione për përdorim nuk do të kërkohen për pajisjet e klasave I dhe II.

3. Rregullat për etiketimin dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve mjekësore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 10

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

#### Prodhimi i pajisjeve mjekësore

1. Prodhimi i pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, si dhe parimet dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

2. Prodhimi i pajisjeve mjekësore në vend kryhet nga persona juridikë, të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin, pas marrjes së miratimit të prodhimit nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas propozimit të Komisionit të Verifikimit të Kushteve të Prodhimit.

3. Komisioni rekomandon dhënien e aktit të miratimit për prodhimin e pajisjeve mjekësore pas plotësimit të kushteve të prodhimit të tyre.

4. Komisioni i Verifikimit të Kushteve të Prodhimit të pajisjeve mjekësore ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Kushtet e ruajtjes dhe të transportit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është autoriteti përgjegjës për revokimin dhe pezullimin e licencave, të përcaktuara në këtë ligj.”.



## Neni 11

Në nenin 22, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri përgjegjës për shëndetësinë është organi që shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar për kërkesat për pajisjen me licencë për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është autoriteti përgjegjës për revokimin dhe pezullimin e kësaj licence.”.

## Neni 12

Në nenin 23, pika 1, fjalët “që mbajnë autorizimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë për tregtimin me pakicë të pajisjeve mjekësore” zëvendësohen me fjalët “të cilët kanë në objektin e tyre të veprimtarisë tregtimin me pakicë të pajisjeve mjekësore”.

## Neni 13

Pas nenit 23 shtohen nenet 23/1 dhe 23/2 me këtë përmbajtje:

## “Neni 23/1

**Rimbursimi i pajisjeve mjekësore**

1. Pajisjet mjekësore rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas procedurës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Hartimi i listës së pajisjeve mjekësore bazohet në kriteret mjekësore, ekonomike dhe sociale.

## Neni 23/2

**Publiciteti**

1. Rregullat për publicitetin e pajisjeve mjekësore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me hollësitë e paraqitura në përmbledhjen e karakteristikave të pajisjes.

2. Publiciteti i pajisjeve mjekësore do të ndalojë çdo informacion që:

a) përshkruan funksione dhe veçanti të pajisjes, të cilat pajisja realisht nuk i ka;

b) krijon një përshtypje false lidhur me trajtimin, diagnozën, funksionet ose veçoritë, të cilat pajisja nuk i ka;

c) dështon në informimin e përdoruesit ose të pacientit për një rrezik të mundshëm, që lidhet me përdorimin e pajisjes, sipas indikacionit që ajo ka;

ç) sugjeron përdorime të pajisjes, të ndryshme nga ato që ajo ka, për të cilat është marrë vlerësimi i konformitetit dhe që i shërbejnë qëllimit të pajisjes.”.

## Neni 14

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

## “Neni 24

**Tregtimi nëpërmjet internetit**

1. Tregtuesit me shumicë dhe pakicë të pajisjeve mjekësore mund t'i blejnë dhe t'i shesin ato nëpërmjet internetit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi.

2. Tregtuesit me shumicë dhe pakicë të pajisjeve mjekësore duhet t'i komunikojnë, paraprakisht, Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore informacionin e nevojshëm mbi pajisjet që do të tregtojnë nëpërmjet internetit.

3. Urdhri, që përcakton kriteret për shitjen me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit, miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.”.

## Neni 15

Në fund të nenit 25 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Pajisjet mjekësore, të përdorura para vendosjes në treg, i nënshtrohen një procesi kontrolli dhe certifikimi nga trupa të notifikuar, sipas përcaktimeve të bëra me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”.

## Neni 16

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:



1. Në pikën 1, shkronja “d”, hiqen fjalët “ose të paraqesë kërkesën për tërheqjen e etiketimeve të papërshtatshme të pajisjeve mjekësore”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Inspektor pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është personi me diplomë universitare jurist, shëndet publik, inxhinier biomjekësor/ klinik/elektronik/kimik, mjek i përgjithshëm/stomatolog, farmacist, ose në shkenca të ngjashme, i cili rekrutohet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi.”

Neni 17

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

**Procedura në lidhje me pajisjet që paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë**

Autoriteti kompetent, në rastet kur konstaton se një pajisje mjekësore e vënë në treg dhe/ose në shërbim paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e pacientëve, përdoruesve ose personave të tjerë, duhet të kërkojë nga prodhuesi i pajisjeve përkatëse apo përfaqësuesi i tij që të ndër marrin të gjitha veprimet korrigjuese, për ta sjellë pajisjen në përputhje me kërkesat e këtij ligji, të kufizojë vënien në dispozicion të pajisjes në treg, të kthejë mbrapsht ose të tërheqë pajisjen nga tregu brenda një periudhe të arsyeshme, që përcaktohet qartë dhe i komunikohet prodhuesit/përfaqësuesit të pajisjes. Pajisjet mjekësore, gjatë ciklit të jetës u nënshtrohen kontrolleve periodike nga trupa të notifikuar, për garantimin e cilësisë e të funksionimit, sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”

Neni 18

Neni 28 shfuqizohet.

Neni 19

Në nenin 30 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) Shkelja e nenit 21, prodhimi i pajisjeve mjekësore pa licencën përkatëse, dënohet me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë.”

2. Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h”, “i”, “j” dhe “k” me këtë përmbajtje:

“ë) Shkelja e pikës 6, të nenit 13, mosdeklarimi i importit nga subjektet tregtuese, dënohet me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

f) Shkelja e nenit 19, rregullat për transportin dhe ruajtjen e pajisjeve mjekësore, dënohet me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

g) Shkelja e pikës 1, të nenit 22, tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore pa licencën përkatëse, dënohet me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”

gj) Shkelja e nenit 23/2, rregullat për publicitetin e pajisjeve mjekësore, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë.

h) Shkelja e pikës 2, të nenit 24, për dhënien e informacionit të nevojshëm Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë.

i) Shkelja e nenit 25, regjistrimi, vendosja në treg dhe përdorimi i pajisjeve mjekësore të përdorura në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë.

j) Shkelja e nenit 27/1, moszbatimi i kërkesave të autoritetit kompetent në lidhje me procedurën për pajisjet që paraqesin rrezik për shëndetin ose sigurinë e pacientëve, dënohet me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë.

k) Tregtimi me pakicë i pajisjeve të paregjistruara dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë.”

3. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rast të përsëritjes së shkeljes më shumë se një herë brenda dy viteve, ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, revokon licencën/at, sipas parashikimeve të këtij ligji.”

Neni 20

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 9, 10, 11 dhe 13 të këtij ligji.



Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11455, datë 26.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Iliir Meta**

**DEKRET  
Nr. 11455, datë 26.3.2020**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 21/20 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014 ‘Për pajisjet mjekësore’”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Iliir Meta**

**VENDIM  
Nr.262, datë 30.3.2020**

**PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË  
INDEKSIMIT TË BAZËS SË  
VLERËSUAR TË VITIT 2018, PËR  
LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 59, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për efekt të llogaritjes së

shumës fillestare mujore të pensionit, të jetë 2.4 për qind.

2. Për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të miraturar me vendimin nr.571, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve” dhe me vendimin nr.180, datë 4.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për llogaritjen e pensioneve”, shtohen edhe me koeficientin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Në vitin 2020, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekësh, e përcaktuar me vendimin nr.809, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 114 670 (njëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit, të nenit 10, të ligjit nr.7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor të miraturar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.571, datë 3.10.2018, dhe nr.180, datë 4.4.2019, si dhe të këtij vendimi, harton dhe shpall tabelën e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar për periudhën deri në vitin 1994 dhe për vitet në vazhdim, deri në vitin 2019, si dhe ngarkohet për zbatimin e tyre.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2020.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 263, datë 30.3.2020**

**PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të nenit 6/1, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të

nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension”, të nenit 8, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.29/2019, “Për për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, dhe të nenit 4, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Indeksimin, në masën 2.3 për qind, të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 dhe 48, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966;

e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të





Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar;

l) pensioneve shtetërore te posaçme, të caktuara në përputhje me nenin nr.5, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar;

ll) përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr.29/2019, “Për për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

m) trajtimeve të veçanta financiare për pensionistët dhe personat që kanë humbur pjesëtarë të familjes nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2020 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2020, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, që kanë datë fillimi të të drejtës deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2020 nuk do të jenë më pak se 14 069 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë në muaj dhe më shumë se 28 139 (njëzet e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2020 nuk do të jenë më pak se 9 634 (nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë në muaj, por jo më shumë se 14 069 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2020 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 14 069 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe nr.150/2014, të caktuara



me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit, do të vazhdojnë të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, nr.477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr.17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave pas indeksimit të pensioneve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 15 719 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneve sipas ligjit nr.150/2014;

b) deri në 15 219 (pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 10 324 (dhjetë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006, nr.763, datë 27.12.2006, nr.415, datë 27.4.2009, dhe nr.477, datë 30.6.2010, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.4.2020 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 719 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj.

8. Përfituesit e pensioneve, sipas shkronjave “a”, “e” dhe “gj”, pikës 1, të këtij vendimi, me

datë fillimi të pensionit deri më 31.12.2014 dhe përfituesit e pensioneve të parakohshme sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr.471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

9. Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit nr.32, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, duke filluar nga data 1.4.2020 e në vazhdim të jetë 7 674 (shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

10. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përlllogariten në shumën 2 100 000 000 (dy miliardë e njëqind milionë) lekë, përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, të parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2020, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

a) 2 083 000 000 (dy miliardë e tetëdhjetë e tre milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a.

11. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit teknik të zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2020.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë